

AKT THEMELIMI I SHOQUERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“OmniSphere” Shpk

Ne Tirane, sot me date 01 Mars 2024, me cilesine e “ortakeve themelues” ne:

- Arjana Tasi, shtetase Shqiptare, e bija e Thoma, lindur ne Tirane me 14/06/1987, ne adresen: Rr. Myslym Shyri, pallati 30, Tirane, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr nr personal I75614016O

- Uilliam Hyseni, shtetas Shqiptar, i biri i ILIR dhe i Arieta, lindur ne Tirane me 28.01.1999, ne adresen: Kopeshti Botanik, Selita e Vjetër, Tirane, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr nr personal J90128042V

me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare” te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Bizneseve”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “OmniSphere” Shpk (me poshte e quajtur “Shoqeria”)

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “OmniSphere” Shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria “OmniSphere” Shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket”, te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne humbjet e shoqërisë deri në pjesën e kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen : Rr. Frederik Shiroka, kulla 3, njesia bashkiake nr 7, Tirana, Shqipëri”.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu

Uilliam Hyseni



edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Aktivitete te teknologjise se informacionit, zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software, testime dhe teste validimi software, dizenjim dhe zhvillim sistemesh software dhe te informacionit dhe komunikimit, zhvillim dhe dizainim te sitemeve te sigurise informatike.

Konceptualizimi, dizajnimi, zhvillimi dhe prodhimi i produkteve dhe sherbimeve per kompani, ndermarrje private ne formen e konsorcium etj ne kontekstin e: Hartimi i programeve dhe projekteve sipas fondeve kombetare, europiane dhe nderkombetare; Asistence per organizatat dhe kompanite publike dhe private ne procesin e nderkombetarizimit dhe programet e bashkepunimit nderkuftar; Hartimi dhe zbatimi i masave per kursimin dhe permiresimin e energjise, perfshire fushata sensibilizuese lidhur me mjedisin, ekonomine dhe mjedisin social; Organizim i panaireve, ngjarjeve kulturore, qendrave te punes dhe showroom-e duke kontraktuar personel, persona logistike, teknologji dhe gjithçka per hartimin dhe zbatimin e perqatitjeve te hapesirave dhe menaxhimit direkt te tyre. Ofrimin e sherbimit te konsulences se aktivitetit ekonomiko-financiar dhe hartimin e raporteve financiar.Ofrimin e sherbimit si komisioner,instalim,mirembajtje dhe tegtim i sistemeve te vezhgimit,akses kontrolli,sistemeve kunder zjarrit,UPS,radio nderlidhje. Ndertimi i linjave elektrike, mbitokesore, ajrore,nentokesore,kabllore per energjine elektrike,linja fuqie dhe Telekomunikacionit,nenstacione elektrike te larta e te mesem etj. Personalizim i kartave ID. "Zhvillim, implementim, mirembajtje, projektim te sistemeve dhe programeve ne fushen e teknologjise se informacionit". Projektim, ndertim dhe implementim i Data Center. Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te lidhur me internetin, etj. Çdo lloj veprimtarie te ligjshme qe konsiderohet fitimprurese per shoqerine. Te gjitha veprimtarite e mesiperme kryhen ne nivel kombetar, nderkombetar, per te gjithe anetaret e Bashkimit European etj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 lekë.

Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga "Ortaket" e shoqerise :

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000,00 leke.

Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga "ortaket" i shoqerise:

William Hysen



Znj.Arjana Tasi, eshte zoteruese e 9 kuota me vlere 9.000,00 leke, e cila perfaqeson 90 % te kapitalit themeltar te shoquerise.

Z.Uilliam Hyseni, eshte zoteruese e 1 kuote me vlere 1.000,00 leke, e cila perfaqeson 10 % te kapitalit

Kontributi i ortaket mund t^e jet^e n^e para ose n^e natyrë (pasuri t^e luajtshme/t^e paluajtshme apo t^e drejta) Ortaket per gjigjen per humjet e shoquerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoquerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoquerise mund te zmadhohet nepermjet n^enshkrimeve t^e pjesëve t^e kapitalit themeltar p^r kontributet n^e para dhe me anë t^e kontributeve n^e natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund t^e zvogëlohet me vendim tunanim t^e Ortakeve te Shqerise n^e t^e njëjtat kushte q^e kërkohen p^r ndryshimin e statutit.

Vendimi p^r zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare t^e Bizneseve p^r regjistrim nga administratori, n^e p^rputhe me nenin 43 t^e ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare t^e Bizneseve".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit t^e një shoqërie me p^rergjegjësi t^e kufizuar e t^e drejtat q^e rrjedhin prej tyre mund t^e fitohen apo kalohen n^epërmjet:

- a) kontributit n^e kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër t^e parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit t^e kuotave me kontratë, kontrata duhet t^e bëhet me shkrim perpara nje noteri.

Ne rastin e shitjes se kuotave nga njeri ortak, ortaku tjeter gezon te drejten e parablerjes se tyre.

Personi q^e kalon kuotën dhe ai q^e e fiton atë p^rergjigjen n^e mënyrë solidare ndaj shoqërisë p^r detyrimet q^e rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit t^e kuotave, deri n^e çastin e regjistrimit t^e kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 t^e ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare t^e Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit t^e kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht t^e transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaket perbejne organin e vetem vendimmarres te shoquerise (Asamblene e Pergjithshme), qe miraton

Uilliam Hyseni



cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendosin për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Neni 10

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji, ose sa here qe është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit "Per shoqerite Tregtare".

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 11

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

William Hyseni



Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Neni 12

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të 2 ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Kuorumi

1. Vendimet ne Asamblese merren nese te pranishem jane te gjithe ortaket.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet te votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.


2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës

Neni 14

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte Znj.Arjana Tasi, e bija e Thoma, shtetase Shqiptare, lindur ne Tirane me 14/06/1987 me numer personal I75614016O.

Ulliem Hysen



Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vit me te drejte riparteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim unanim te Ortakeve te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 15 Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut te vetem për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen Asamblese se Pergjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtezakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoriteteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 16 Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara unanimisht nga Ortake që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

William Hysen



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) i kthen ortakut kontributet;

b) i paguan ortakut interesa apo dividendë;

c) i shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 17 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Bizneseve dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 18 Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Asambleja e Pergjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Asambleja e Pergjithshme vendos rrëth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 19 Baza Ligjore

William Hyseni

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "**OmniSphere**" shpk, u redaktua nga "Ortaket Themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejtave juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike.

ORTAKET

"OmniSphere" Shpk

Arjana Tasi



Uilliam Hyseni

